URDHËR
Nr. 537, datë 29.9.2020

PËR SHFUQIZIMIN E URDHRIT TË MINISTRIT NR. 320, DATË 15.5.2020 "PËR DISA KUFIZIME NË OFRIMIN E SHËRBIMEVE NË BARE, RESTORANTE DHE LOKALE, *FAST-FOOD*"

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të nenit 7, pika 4, të ligjit nr. 15/2016, "Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive", nenit 113, të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", udhëzimeve të Institutit të Shëndetit Publik, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga Covid-19 në Republikën e Shqipërisë, si edhe vendimit të Komitetit Teknik nr. 4286, datë 23.9.2020,

URDHËROJ:

1. Shfuqizimin e urdhrit nr. 320, datë 15.5.2020 "Për disa kufizime në ofrimin e shërbimeve në bare, restorante dhe lokale, *fast-food*".
2. Shërbimi në bare, restorante dhe lokale, *fast-food* të ofrohet në përputhje me protokollet e miratuara nga Instituti i Shëndetit Publik për parandalimin e përhapjes së infeksionit Covid-19.
3. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri Inspektorati Shtetëror Shëndetësor, Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe fillon efektet më datë 1.10.2020.

MINISTËR I SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu